



Plani i veprimit të menaxhmentit të AKK-së, për zbatimin e rekomandimeve nga
Raporti i Auditimit të ZKA-së, për Pasqyrat Financiare të përfunduara me 31 dhjetor 2021

Data: 28.06.2022.

Çështja E gjetura Ndikimi Rekomandimi	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
<p>Çështja A1: Zotimi dhe urdhërblerja pas pranimit të faturave</p> <p>E gjetura: Bazuar në kërkesat e Rregullës financiare Nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike, përcakton që së pari duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-bleerja, pranohet malli apo shërbimi dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Gjatë testimi në 3 pagesa në vlerë 5,778€, në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe ishte nxjerr urdhërblerja. Kjo ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur.</p> <p>Ndikimi: Mos ndjekja e hapave siç kërkohet gjatë kryerjes së pagesave, është shmangie nga kërkesat ligjore dhe mund të rezultojë me dobësi në procesin e ekzekutimit të pagesave.</p> <p>Rekomandimi A1: Kryetari i AKK duhet të siguroj kontrollë të rregullta në procesin e ekzekutimit të pagesave, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullën në fuqi.</p>	<p>Kryetari i AKK-së do të siguroj kontrollë të rregullta në procesin e ekzekutimit të pagesave, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullën në fuqi.</p>	<p>31.07.2022.</p>	<p>Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF)</p>



Çështja A2: Prezantim jo i drejtë i pasurive nën 1,000€ në PFV

E gjetura: Sipas nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rreg. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Gjatë testeve kemi vërejtur që AKK edhe pse kishte regjistruar blerjet e vitit në vlerë 11,742€ në regjistrin e e-pasurisë apo regjistrin e pasurive nën 1,000€, për këto pasuri nuk ishte përlllogaritur zhvlerësimi. Bazuar në këto, vlera e prezentuar në PFV është e mbivlerësuar duke mos prezentuar vlerën e drejtë të tyre. Kjo ka ndodhur për arsye të mos azhurnimit të të dhënave me arsyetimin që nuk kishte kontratë për mirëmbajtje të sistemit e-pasuria nga MAP/MPB.

Ndikimi: Prezentimi i pasurive nën 1,000€ në PFV duke mos përlllogaritur zhvlerësimin reflekton me prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV, duke e mbivlerësuar vlerën e tyre.

Rekomandimi A2: Kryetari i AKK duhet të sigurojë që për të gjitha pasuritë janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

E gjetura qëndron, por jo se Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë që për të gjitha pasuritë të janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë, por se MPBAP duhet me kohë të siguroj kontratë për mirëmbajtje të sistemit e-pasuria.

?

MPBAP

